



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KORÇË
KRYETARI

Nr. 499 prot.

Korçë, më 21.01.2019

URDHËR

Nr. 30 datë 21.01.2019

PËR DHËNIEN ME QIRA TË TRUALLIT ME SIPËRFAQE 205 M² PJSË E PASURISË Nr.2/353 ZK
8563 PËR QËLLIME BIZNESI

Bazuar në nenin 64 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në kreun II pika 5 e VKM nr.54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar; Udhëzimit Nr.13 datë 26.04.2018 "Për zbatimin e V.K.M-së nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.129 datë 09.11.2018 "Për fillimin e procedurave të dhënies me qira të truallit me sipërfaqe 205 m2, pjesë e pasurisë nr.2/353 ZK 8563, për qëllime biznesi" Kryetari i Bashkisë:

URDHËROJ

1. Fillimin e procedurave për dhënie me qira me anë të procedurave të konkurrimit të Truallit me sipërfaqe 205 m2, pjesë e pasurisë Nr.2/353 ZK 8563.
2. Kjo sipërfaqe të jepet me qira për qëllime biznesi.
3. Çmimi dysheme për fillimin e konkurrimit është 100 lek/m2/muaj.
4. Afati i dhënies me qira është 1 vit.
5. Vlerësimi i konkurrentëve do të bëhet sipas këtyre pikëve:

Tarifa mujore e qirasë:	50 pikë
Punësimi:	20 pikë
Investimi:	30 pikë

6. Konkurrimi do të bëhet në datën 05/02/2019, në orën 10:00 pranë Bashkisë Korçë.
7. Komisioni për shqyrtimin e ofertave do të përbëhet nga:

Kletjon Kita	Kryetar
Klajdi Jaçe	Anëtar
Olvas Petro	Anëtar

8. Dokumentacioni që do të paraqesin konkurrentët për konkurrim përmban:

1. Kërkesën e subjektit për marrje me qira, ku të deklarohej:
 - a. oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë,

- b. qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore,
 - c. treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit.
3. Plan-biznesin e hollësishëm në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
- a. Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;
 - b. Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
 - c. Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
 - d. Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.
4. Deklarata në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:
- a. Deklaratë për të dhënat e Nuis/Nipt të subjektit kërkues;
 - b. Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;
 - c. Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
 - d. Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë, në objekte pronë shtetë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;
 - e. Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Klajd Jaçe

Drejtore e Përgjithshme:
Anxhela Dishnica

KRYETARI I BASHKISË
Sotirag PULO

